



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1008/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevc, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Sabri Micaj, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1008/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Sabri Micaj, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Sabri Micaj, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate dega Prizren, me të cilën thekson se në qendrën e votimit 2054A/01D kërkon që të bëhet rinumërimi i votave pasi që sipas parashtruesit të apelit ka parregullsi në paraqitjen e rezultateve të votave në mes të votave të cilat janë publikuar në formular dhe votuesve të Nismës, andaj i njëjti thekson se bazuar në fakte dhe argumente kërkon që vendvotimet e cekura më lart të kthehen në rinumërim.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për manipulime të votave, edhe pse në kuptim

të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e tij janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për atë për të cilën pretendon, andaj edhe nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Sabri Micaj, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate dega Prizren,, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave në vendvotimin e lartcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.1008/2021 më datën 07.11.2021

Kryesues i Panelit
Zyhë Haxhin



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.